

RAPORT PRELIMINAR

"Qendra Historike" e Prishtinës numëron ditët e fundit

Rrëfimi për Prishtinën fillon me Zonën Historike të saj. Themeluar që nga shekulli i XIII, të dhënat tregojnë se kjo zonë është ndër të vetmet pjesë të strukturës urbane që ka vlera autoktone dhe mjedisore të trashëgimisë kulturore. Nga koha kur përmendej si "fshat", e deri në kohën e formësimit të kryeqendrës së ditëve të sotme, Prishtinës i parapriu zhvillimi i koncentruar i bërthamës së qytetit. I shtrirë në mes të dy lumenjëve, qyteti u zhvillua ndër shekuj duke u dalluar për indin e rrugëve, objektet publike, ato fetare, çarshinë, kullën, hamamet, shtëpitë individuale e pse jo edhe për lëkurpunuesit, qeleshepunuesit, kazangjinjtë, vorbëtarët, cergaxhinjtë e të gjithë zejtarët e saj. Ajo që e bën të njihet jo për të mirë është trajtimi i saj politik dhe kulturor ndër shekuj. Në Prishtinë u aplikuan metodologji shkatërruese dhe degraduese, duke filluar nga misioni për të sjellur modernen nën moton "Ta rrënojmë të vjetrën, ta ndërtojmë të renë", e duke vazhduar me shkatërrimet e vazhdueshme të cilat ndodhin paralelisht në kohën të cilën po e jetojmë. Me identitetin e Prishtinës u eksperimentua dhe po vazhdon të eksperimentohet!

GJENDJA AKTUALE

Degradimi i vazhdueshëm i "Qendrës Historike" të Prishtinës (ndërtimi i strukturave të reja dhe intervenimet në ato të vjetrat) - Prishtinasit e vjetër, dhe jo vetëm, kanë shumë pak të kujtojnë nga Prishtina e dikurshme. Komuniteti i gjerë e ka lehtë të identifikushme realitetin e asaj që është duke ndodhur në "Qendrën Historike" të Prishtinës. Disa shtëpi janë në rrënim e sipër, të tjerat janë djegur me apo pa qëllim, ndërsa dita ditës strukturat e vjetra po zëvendësohen me ato të reja. Restaurimet në disa objekte publike dhe fetare po vazhdojnë duke nxitur kritika për korrektësinë profesionale dhe juridike të intervenimeve në to. Gjendja e objekteve brenda kufijve të "Zonës Historike" të dikurshme është shqetësuese! Mirëmbajtja e objekteve dikur nën mbrojtje shtetërore përkeqësohet dita-ditës. Trajtimi i ndryshëm i fasadave ballore, aplikimi i materialeve jo-adekuate, trajtimi jo-adekuat i përmbajtjeve afariste në përdhese janë duke e degraduar vazhdimisht këtë zonë. Por këto përcillen edhe me intervenime të tjera megalomane, siç janë ndërtimet e objekteve të reja që tentojnë t'i korrespondojnë arkitekturës bashkëkohore, e që në fakt, i tjetërsojnë vlerat ekzistuese të trashëgimisë kulturore.

Heshtja e trajtimit të saj nga insitucionet dhe profesionistët - Përderisa "Qendra Historike" e Prishtinës po shkatërrohet, institucionet dhe njerëzit e fushave profesionale të lidhura me çështjen, pothuajse janë në heshtje të plotë. Për "Qendrën Historike" është duke u shkruar shumë pak dhe opinioni i gjerë përveç asaj që mund ta shoh dhe përjetojë vet, nuk provokohet aq shumë as nga mediet. Shqetësues është fakti se mungon promovimi i vlerave ekzistuese të trashëgimisë kulturore brenda "Zonës Historike" të dikurshme. Kjo paraprin edhe vetëdijen e ulët të qytetarëve, shumëherë të vet banorëve të pronave të mbrojtura, për degradimin e qëllimshëm të vlerave ekzistuese.

Venitja e kujtesës kolektive për ekzistimin e vlerave - Faktori kohë ka bërë që gjeneratat e reja, por edhe te vjetrat të kenë pak çka të kujtojnë nga trashëgimia kulturore dhe urb-arkitektonike e kësaj zone. Mungojnë publikimet apo aktivitetet kulturore për ngritjen e vetëdijësimit për ekzistimin e vlerave në këtë zonë. Mungon interpretimi i këtyre vlerave edhe nga insitucionet edukativo-arsimore. Shkatërrimi i kësaj zone ka implikuar më së shumti shkatërrimin e kujteses kolektive për ekzistimin e vlerave dhe ruajtjen e tyre.

ZHVILLIMET NGA '78-TA

Planifikimi urban në zonë dhe vendimet e dala gjatë viteve - Duke filluar nga Plani Gjeneral i Prishtinës i vitit 1951, e duke vazhduar me planet e tjera urbane, pjesës qendrore të Prishtinës iu kushtua trajtim i posaçëm si rezultat i shkatërrimeve të bëra në qendrën kulturore, ekonomike e administrative të saj. Meqenëse munguan fondet për realizimin e të gjithë invazionit prishës-ndërtues, një numër i veprave të arkitekturës tradicionale arriti që të mbijetonte. Ato u cilësuan dhe u shpallën si monumente kulturore! Ndërsa viti 1978 është vit për tu shënuar në aspektin e zhvillimit të bërthamës së Prishtinës. Plani detal urbanistik i vitit 1978, hartuar nga Enti për Urbanizëm i Prishtinës, duke vlerësuar strukturën ekzistuese urbane dhe në bazë të koncentrimin të objekteve të vlerësuara nën mbrojtje, ka vërtetuar kufijtë e të ashtuquajturës "Zonë Historike". Përkundër shkatërrimit të tregut të vjetër dhe shumë objekteve tradicionale, kjo zonë ende kishte vlera historike, arkitektonike dhe mjedisore, dhe si e tillë kërkonte trajtim të veçantë! Një shqyrtim i ngjashëm kësaj zone iu bë edhe me planin e ri gjeneral të 1987-tës, edhe pse efektet negative të zhvillimeve në zonë vetëm sa po shtoheshin. Më vonë, në vitin 2004 autoritetet e Prishtinës miratuan një plan të ri strategjik urban si preventivë e kanosjeve enorme në këtë zonë. Tek në 2006-tën u iniciua procesi i hartimit të një plani rregullativ për të ashtuquajturin "Oytetin e vjetër" të Prishtinës, për tu vazhduar në 2009-tën me zgjerimin e kufijëve të dikurshëm të zonës në 42 ha (prej 20 ha sa ishin). Është e diskutueshme nga ekspertët se si u vendos për shtimin e kësaj sipërfaqeje. Cili ishte kriteriumi dhe qëllimi?!

Aktiviteti ndërtimor në zonë është duke vazhduar duke qenë i pa planifikuar dhe i pa monitoruar. Plani rregullativ i kësaj zone është inicuar (me procedurat e tenderimit) tri herë rradhazi nga Komuna e Prishtinës dhe është ndërprerë për shkak të kërkesës për përpilimin paraprak të Planeve Rregulluese të Hollësishme.

Statusi ligjor i zonës dhe i objekteve në veçanti - Zona në fjalë, e konceptuar si "Qendra Historike" e Prishtinës, momentalisht nuk gëzon kufij të definuar. Si e tillë asaj i mungon statusi ligjor dhe nuk është e mbrojtur si zonë! Dhe jo vetëm kaq... Objektet e kësaj zonë dikur në mbrojtje shtetërore, nga ligji i regjimit jugosllav/serb, sipas Ligjit të Kosovës për trashëgimi kulturore nga viti 2006 gëzojnë një status tjetër, atë të mbrojtjes së përkohshme. Ky status duhet të ri-shqyrtohet çdo vit! Statusi mbrojtje e përkohshme vazhdohet sipas procedurës së rishikimit dhe rivlerësimit çdo vit, dhe si produkt final ka Listën e Trashëgimisë Kulturore nën Mbrojtje të Përkohshme.

Bartja e përgjegjësiwe institucionale - Ruajtja, mbrojtja dhe zhvillimi aktiv dhe i mirëfilltë i trashëgimisë kulturore është detyrim kushtetues. Ligji për Trashëgiminë Kulturore, i miratuar në 2006-tën, lidhur me plotësimin e këtyre detyrimeve, ka ngarkuar autoritet dhe institucionet siç janë: Kuvendi i Republikës së Kosovës, Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore (KKTK), Qeveria qendrore (Kryeministria, MKRS, MMPH, institucionet e trashëgimisë kulturore, të planifikimit territorial dhe kadastrit) dhe Qeverinë lokale. Ndryshimet në ligj-bërje dhe procesi i krijimit të kësaj hierarchie institucionale ka ndikuar edhe në zhvillimet e fundit në Qendrën Historike të Prishtinës.

Demolimi, djegja dhe shkatërrimi i një numri të konsiderueshme të objekteve të trashëgimisë në zonë - Të dhëna relevante tregojnë për një përqindje të lartë (44%) të shkatërrimit të objekteve dikur të mbrojtura ligjërisht. Gjendja e shumë objekteve (sidomos të shtëpive individuale) është mjaft e rëndë. Vizuelisht mund të supozohet se shumë prej tyre janë në rrezik të rrënimit të pjesshëm. Gjatë dy dekadave të fundit, nuk mungojnë rastet e rrënimit të qëllimshëm të strukturës së vjetër, për ta bërë zëvendësimin e saj me të rene. Gjendja ekzistuese e monumenteve është rrezikuar edhe nga ndërtimet reja të cilat nuk kanë respektuar rrezin e obliguar për distancim në rastin e objekteve nën mbrojtje.

Restaurimet ne objektet brenda zonës - Përderisa monumentet brenda zonës së konceptuar si "Qendra Historike" e Prishtinës vazhdojnë të gëzojnë mbrojtje të përkohshme, faktori kohë ka ndikuar edhe në gjendjen e tyre të përgjithshme. Autoritetet qeverisëse ne mes të objekteve të banimit dhe atyre fetare e administrative, kanë zgjedhur këto të fundit si më parësore për intervenimet e procesit të restaurimit. Mirëpo intervenimet e tilla, edhe pse me investime të konsiderueshme, janë cilësuar negativisht nga shumë kritik. Projektet e restaurimit mendohet se më shumë kanë zbehur vlerat e gjendjes burimore të objekteve. Është vlerësuar se nuk janë konsideruar konventat ndërkombëtare për mbrojtjen e trashëgimisë dhe nuk janë konsultuar profesionistë të lëmive relevante. Mungon poashtu dokumentacion i plotësuar me analizat paraprake për përcaktimin e destinimit të ri të objekteve në fjalë pas restaurimit (posaçërisht rasti i Hamamit të madh). Poashtu është për tu shqyrtuar relacioni i punëkryesve dhe autoriteteve mbikqyrëse, për të cilët mendohet të ketë shkelje ligjore dhe shfrytëzim të postit për përfitime personale. Të gjitha këto kanë ndikuar në degradimin e këtyre monumenteve me rëndësi në rradhë të parë historike.

Publikimet në lidhje me zonën - Përkundër faktit se institucionet përkatëse kanë patur për detyrë që në vazhdimësi të bëjnë inventarizimin apo edhe incizimin e aseteve të trashëgimisë kulturore, mungojnë materialet arkivore, materialet bibliotekare si dhe materialet audio-vizuele. Dhe edhe nëse këto të fundit ekzistojnë, mungon një përbledhje e tyre dhe analizë e vërtetësisë së të dhënave. Pozitive në këtë drejtim mund të konsiderohen prurjet nga dy publikimet e fundit, "Trashëgimia e Prishtinës", CHwB dhe "Bazat e konzervimit për Qendrën Historike të Prishtinës", BE/KIE. Përkundër mangësive eventuale, këto dy publikime përbejnë të vetmet burime të kësaj natyre dedikuar bërthamës historike të Prishtinës në aspektin kulturor, urbanistik dhe arkitektonik të saj.

PROBLEMATIKAT

Gjendja ekzistuese në Qendrën Historike të Prishtinës rezulton të jetë alarmante. Aktivitetet brenda zonës dhe avaria e përgjegjësiwe insituacionale sjellin në pah këto problematika kryesore:

Mungesa e bashkëveprimit insituacional (MKRS-MMPH-KK) - Bashkëveprimi në mes të këtyre tri insituacioneve rezulton të jete një qark që nuk mbyllet. MKRS bart barrën kryesore, dhe si e tillë nga ekspertët akuzohet për ngecjen e procesit të bashkëveprimit në mes të MMPH dhe në këtë rast Komunës së Prishtinës. Thirrjet nga këto të fundit për mobilizim të një iniciative për definimin e problematikës së statusit të zonës dhe objekteve si dhe kufijëve të zonës, rezultojnë të mos jenë pritur me entuziazëm.

Mungesa e kufijëve të definuar zonës - Mungesa e kufijëve ligjor paraprihet nga mungesa e kufijëve të definuar të zonës. Edhe pse për "Qendrën Historike" të Prishtinës shpesh referohemi si "Zonë Historike" e Prishtinës, në fakt ajo nuk është fare e definuar si e tillë. Edhe pse mund të referohemi në kufij të ndryshëm të planeve urbanistike ndër vite, ky nuk është komponenti i vetëm. Kufijt e zonës duhet të definohen në bazë të mbetjeve dhe potencialit të mundshëm të vlerave të trashëgimisë kulturore.

Mungesa e statusit ligjor për zonën - Pa definim të kufijve të asaj që do ta përcaktonin si zonë, sipërfaqja e trajtuar me përmbajtje të mundshme të vlerave të trashëgimisë kulturore nuk mund të definohet me status ligjor. Fakti që kjo zonë nuk është e mbrojtur, ka ndikuar drejtpërdrejt në degradimin e vazhdueshëm të saj. Në rast se kjo zonë do të gëzonte status të përcaktuar (në mbrojtje) atëherë kjo do ta ndihmonte në parandalimin e të gjitha aktiviteteve zhvillimore negative në të dhe rrethinë. Vetëm statusi në mbrojtje (të përkohshme) i monumenteve në veçanti, nuk e ka ndihmuar mbrojtjen e zonës në përgjithsi.

Statusi i përkohshëm i dhënë për objektet në mbrojtje - Kalimi nga mbrojtja e përhershme në mbrojtje të përkohshme, vetëm sa i ka dëmtuar monumentet dhe gjendjen burimore të tyre,

konsiderojnë ekspertët. Fillimisht kjo i ka kthyer në një gjendje të mëhershme të shqyrtimit të tyre, duke ditur që monumentet se pari shpallen nën mbrojtje të përkohshme dhe më pas të përheshme. Përfundimisht monumentet brenda kësaj zone kërkojnë re-inventarizim dhe definim të statusit të tyre në mënyrë që të parandalohet shkatërrimi i vazhdueshëm në emër të jo seriozitetit të statusit që e gëzojnë.

Aktiviteti ndërtimor brenda zonës (ndërtimet pa leje/ leje të kontestueshme dhe jo-përgjegjësia institucionale) - Aktiviteti ndërtimor në këtë zonë nuk ka të ndalur. Edhe pse nga autoritetet komunale këto mohohen, objekte të reja, në disa raste edhe të një etazhiteti të mesëm dhe të lartë janë duke u ndërtuar në afërsi të objekteve nën mbrojtje. Ekziston një paqartësi në rrugën të cilët duhet ta ndjekin aplikuesit për leje ndërtimore në këtë zonë. Përderisa Komuna e Prishtinës supozon se i procedon kërkesat në Qendrën Rajonale për Trashëgimi Kulturorë, rekomandimet e këtyre të fundit rezultojnë të mos mirren parasysh. Struktura të reja janë duke u ndërtuar në afërsi të monumenteve nën mbrojtje duke mos respektuar etazhitetin, konceptin e arkitekturës tradicionale të zonës, materializimin, si dhe rrezën e distancimit.

Mosndëshkim i personave të cilët qëllimisht kanë shkatërruar dhe degraduar objekte të cilat kanë qenë nën mbrojtje - Është bërë traditë që të digjet apo shkatërrohet e vjetra në mënyrë që lirshëm t'i lëshohet vend të resë. Pronarët e objekteve me vlera të trashëgimisë kulturore, të pakënaqur me gjendjen e objekteve për të cilat duhet të kujdesen vet dhe pa përkrahje dhe lehtësime nga institucionet, zgjedhin që të shkatërrojnë pronat e tyre, të joshur nga përfitimet që mund t'i kenë nga ndërtimet e reja si zëvendësim! Mungon penalizimi i kryesve të këtyre krimeve ndaj vlerave kulturore.

REKOMANDIMET

Në këtë raport preliminar, i cili i paraprin një raporti të hollësishëm të cilin do ta publikojë së shpejti "EC Ma ndryshe", ne i ofrojmë këto rekomandime urgjente:

Ndërprerja e përkohshme e të gjitha aktiviteteve ndërtimore në zone (strukturave të reja si dhe intervenimet në ato të vjetrat) – Për të parandaluar shkatërrimin dhe degradimin e mëtutjeshëm në zonë, ne i bëjmë thirrje institucioneve komunale që të ndërpritet në afat të pacaktuar çdo aktivitet ndërtimor.

Rishqyrtimi i përgjegjësive institucionale sipas ligjeve në fuqi - Të shqyrtohet mungesa e bashkëveprimit në mes të institucioneve përgjegjëse të percaktuara me Ligjin për Trashëgiminë Kulturorë. Mungon bashkëveprimi në mes të MKRS-MMPH-KP. Poashtu edhe në funksionimin e KKTK ka ngecje. MKRS të detyrohet për mobilizim të menjëhershëm të marrjes së situatës nën kontroll.

Angazhimi i ekspertëve nga lëmia e trashëgimisë, urbanizmit, arkitekturës, historisë, artit dhe jurisprudencës (përfshi edhe përfaqësuesit nga Universiteti i Prishtinës) - Meqenëse shqyrtimi i "Qendrës Historike" të Prishtinës është çështje shumë komplekse dhe me përgjegjësi të lartë është e nevojshme që të përfshihen profesionistë të lëmive të lartëcekura, pa anashkaluar edhe ekspertët ndërkombëtarë të dëshmuar në trajtimin e qendrave historike.

Të valorizohet çka ka mbetur nga kjo zonë (të mirret një akcion incizimi dhe inventarizimi në terren për shqyrtimin e objekteve të mbetura dhe të bëhet vlerësimi i vlerave të trashëgimisë dhe atyre urb-arkitektonike në zonë) - Për shkak të dinamikës së aktiviteteve negative në zonë, të shkatërrimit dhe ndërtimit jo-adekuat të zonës, është më se e nevojshme që të kundër-veprohet me të njejtën tempo. Mobilizimi i grupeve të studentëve apo edhe vullnetarëve të përcjellur nga një staf profesionit për të bërë incizimin e gjendjes në terren do t'i paraprinte procesit të vlerësimit se çka ka mbetur si vlerë e ruajtur nga lista e dikurshme e objekteve me mbrojtje të përhershme dhe çka nga "Zona Historike" e '78-tës.

Të bëhet definimi i kufijve - Njohja e vlerave të mbijetuara të objekteve brenda zonës do t'i paraprinte procesit të përcaktimit të kufijve të saj. Objektet me vlera të trashëgimisë kulturore dhe potenciali i zhvillimit të aktiviteteve në afërsi të tyre do të shërbente si indikator për nevojën e zgjerimit (apo ngushtimit) të kufijve të "Zonës Historike" të dikurshme .

MKRS të ofrojë status ligjor (për zonën në përgjithsi dhe objektet në veçanti) - Në afat sa më të shkurtë Ministria e Kulturës thirret të japë status të definuar si mbrojtje e përhershme për objektet me vlera të trashëgimisë kulturore brenda zonës. Kjo do të pengonte dhe ndalonte perfundimisht degradimin e vazhdueshem të tyre, krijonte hapësirë për penalizimin e kryesve të këtyre shkatërrimeve dhe mbrojtjen e këtyre pak objekteve të shpëtuara nga degradimi i viteve të fundit. Poashtu zona si sipërfaqe e definuar duhet të gëzoj status të definuar, i cili do t'i mbronte kufijtë e saj dhe të gjithë aktivitetin ndërtimor brenda saj.

Të procedohet me planin e Konservimit - Rivlerësimi dhe ripërcaktimi i territorit të "Zonës Historike" të dikurshme të Prishtinës do të hapte mundësinë e thirrjes për Konservim dhe hartimin e planit të Konservimit.

SHËNIM

Ky raport preliminar paraprin prodhimin e raportit të hollësishëm përfundimtar për "Qendrën Historike" të Prishtinës

SHKURTESAT

MKRS Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit
MMPL Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
KTK Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturor
QRTK Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturor
BE-KIE Bashkësia Evropiane-Këshilli i Evropës
KP Komuna e Prishtinës

LITERATURA

Trashëgimia e Prishtinës, CHwB Kosovo office, 2008
Bazat e Konzervimit për "Qendrën Historike" të Prishtinës, 2012
Conservation of Hirsotic Buildings, Bernard M Feilden, 2007
A history of Architectural Conservation, Jukka Jokilehto, 2006
Konventa për Mbrojtjen e Trashëgimisë Arkitekturale të Evropës, PDKK, 2010
Udhëzues për Trashëgiminë Kulturorë, PCDK, 2012
Plani Urbanistik Detal për Zonën Zejtare të miratuar në vitin 1978, Komuna e Prishtinës-arhiva
Generalni Urbanistički Plan Prištine do 2000 godine, Skupština Opštine Priština, 1987
Stari Balkanski Gradovi, Branislav Kojic, 1977

INTERVISTAT

Gjejlane Hoxha, Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturor
Avni Manaj, Promovimi i Diversitetit Kulturor në Kosovë; Bashkësia Evropiane-Këshilli i Evropës
Festa Nela, Insituti për Planifikim Hapësinorë; Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Burbuqe Hydaverdi, Drejtoria për Urbanizëm;Komuna e Prishtinës
Vjollca Aliu, Drejtoria për Trashëgimi Kulturorë; Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit
Burbuqe Deva, Qendra Rajonale e Trashëgimisë Kulturorë
Sali Shoshi, CHwB, zyra në Kosovë
Valbona Saliuka, Qendra Rajonale e Trashëgimisë Kulturorë
Agim Gërguri, Insituti për Mbrojtjen e Monumenteve të Kosovës
Gani Gashi, Insituti për Mbrojtjen e Monumenteve të Kosovës
Haxhi Mehmetaj, Qendra Rajonale e Trashëgimisë Kulturorë
Rexhep Vula, arkitekt i pavarur